

STUDIM MBI ÇËSHTJET MJEDISORE RAJONI JUGOR

Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri

Studim tematik mbi çështjet mjedisore në rajonin jugor

COSV
Coordinamento delle organizzazioni per il servizio volontario

Shtator 2023

Publikuar nga:
COSV në Shqipëri
Adresa: Rruga e Ullinjve, Rezidenca " Kodra e Diellit ", njësia 1/1

Tiranë, Shqipëri



Web: www.cosv.org

Email: infoalbania@cosv.org

Projekti: "Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri"

Autorë:

Xhekiola Beqiri

PhD.C. Sonila Xhemali

Phd. Isijda Sinjari

Eksperte mjedisi

Koordinatorë rajonale COSV në Shqipëri

Drejtores ekzekutive e COSV në Shqipëri

Redaktoi: **Ana Zhibaj**

Shënim

"Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit Green-AL, një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida, me fondet e Qeverisë Suedeze. Mendimet dhe sugjerimet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë me domosdoshmëri pikëpamjet e donatorit".

TABLE OF CONTENTS

RRETH GREEN-AL	5
1. SFONDI RAJONAL	8
1.1 TË DHËNA GJEOGRAFIKE DHE ADMINISTRATIVE	8
1.2 BURIMET NATYRORE	9
1.3 ASPEKTI SOCIAL-EKONOMIK	10
1.4 TË DHËNA DEMOGRAFIKE	11
2. PALËT E INTERESUARA	12
2.1 AKTIVITETET E PROJEKTEVE	12
2.2 PJEËMARRJA NË PROJEKTE	14
3. PROJEKTET E ZBATUARA	15
3.1 PROJEKTI: EKOMUZEUMI I ZVËRNECIT “NJË INSTRUMENT PRAKTIK PËR PROMOVIMIN E NATYRËS, KULTURËS DHE AVENTURËS NË PEIZAZHIN E MBROJTUR V JOSË-NARTË”	15
3.2 PROJEKTI ZHDUKJA E EKOSISTEMEVE NGA AKTIVITETI I MINIERAVE TË GURIT	33
3.3 KRIJIMI I MODELIT TË STRUKTURAVE TË MIRËMBAJTJES SË VIJËS BREGDETARE DHE BREGLIQENORE SI FUNKSIONE TË BASHKIVE RESPEKTIVE.	39
3.4 PROJEKTI: NXITJA E NISMAVE LOKALE PËR REDUKTIMIN E MBETJEVE URBANE NË LUMIN E QYTETIT DHE LUMIN E VËRDOVËS	46
3.5 PROJEKTI: BERATI, QYTETI I GJELBËR DHE TË RINJ TË NDËRGJEGJSHËM.....	50
4. SUGJERIME	54

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Ndarja territoriale e vendit për qëllime menaxheriale të Green-AL	7
Figura 2: Qyetet e rajonit jugor	15
Figura 3: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata ASTER.....	17
Figura 4: Vizitë studimore në Eko-muzeun e "Palude la Vela e Mar Piccolo".....	18
Figura 5: Vizitë studimore në Eko-muzeun e "Palude la Vela e Mar Piccolo".....	19
Figura 6: Vizitë studimore në Eko-muzeun e Zvërnecit.....	20
Figura 7: Trajnim dy-ditor nga Shoqata ASTER me qëllim rritjen e kapaciteteve të guidave.....	20
Figura 8: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata CERCI.....	21
Figura 9: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata CERCI.....	22
Figura 10: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata ASTER.....	23
Figura 11: Konceptimi teknik dhe shkencor i eko-muzeut Burimi: Shoqata CERCI.....	24
Figura 12: Konceptimi teknik dhe shkencor i eko-muzeut Burimi: Shoqata CERCI.....	25
Figura 13: Konceptimi teknik dhe shkencor i eko-muzeut Burimi: Shoqata CERCI.....	26
Figura 14: Vizitë studimore në Eko-muzeun e Zvërnecit.....	26
Figura 15: Aktiviteti "Komuniteti dhe Peizazhi".....	28
Figura 16: Promovimi i një imazhi të ri të eko-muzeut të Zvërnecit.....	29
Figura 17: Rafting në lumin Vjosa.....	31
Figura 18: Aktiviteti outdoor "Ecobike".....	32
Figura 19: Bashkia e Himarës.....	33
Figura 20: Guroret në Vranisht, Vlorë.....	34
Figura 21: Takim në Vranisht, Vlorë.....	35
Figura 22: Takim në Vranisht, Vlorë.....	36
Figura 23: Mbjellje pemë në Vranisht, Vlorë.....	37
Figura 24: 3 ishujt në Ksamil.....	40
Figura 25: Plazhi i Ri, Sarandë.....	40
Figura 26: Plazhi i Pllakave, Sarandë.....	41
Figura 27: Takim Bashkia Sarandë.....	42
Figura 28: Roll up statik me mesazhe ndërgjegjësimi për kujdesin ndaj ndotjes detare.....	43
Figura 29: Takime me tematikë "Ripërdorimi i mbetjeve që nxirren nga fundi i detit, duke krijuar me to vepra artistike, funksionale për qyteti.....	44
Figura 30: Aktivitet ndërgjegjësimi me nxënësit e gjimnazit "Muharrem Çollaku"	47
Figura 31: Pastrimi i lumit të Vërdovës.....	48
Figura 32: Aktivitet ndërgjegjësimi me nxënësit e gjimnazit "Muharrem Çollaku"	49
Figura 33: Takime me komunitetin e zonës përgjatë lumit të Vërdovës	49
Figura 34: Aktivitet ndërgjegjësimi i qytetarëve.....	51
Figura 35: Aktivitet ndërgjegjësimi i nxënësve.....	52
Figura 36: Foto nga fushata e pyllëzimit.....	53

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Aktivitetet e zhvilluara në projektet e rajonit jugor	13
Grafiku 2. Pjesëmarrja e aktorëve kryesorë në aktivitetet e zhvilluara në projekte.....	14

LISTA E SHKURTIMEVE

ADZM	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ASTER	Shoqata për Turizmin e Qëndrueshëm dhe Kërkimit Mjedisor
CELIM	Qendra Laike Italiane për Misione
CERCI	Edukim Komunitar për të Drejta Kulturë Integrim
COSV	Organizatë jo-qeveritare e Bashkëpunimit për Zhvillim
CO PLAN	Instituti për Zhvillimin e Habitatit
GIZ	Zyra Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
GREEN AL	Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri
INSTAT	Instituti i Statistikave
NATGA	Shoqata Kombëtare e Guidave Turistike Shqiptare
OJF	Organizata jo-fitimprurëse
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
PM	Peizazh i Mbrojtur
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNESCO Kulturën	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

RRETH GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri", Green-AL, janar 2021 – dhjetor 2023, zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me CISP, *Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli*; VIS, *Volontariato Internazionale per lo Sviluppo*; COSV, *Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario, (Partneriteti)*. Green-AL është një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Sida), me fondet e Qeverisë Suedeze.

Projekti ka pasur për qëllim të japë kontribut në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve mjedisore dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve, organizatave me bazë lokale, autoriteteve publike në nivel lokal e kombëtar, institucioneve arsimore, bizneseve dhe komunitetit duke synuar krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesit për të ngritur e trajtuar çështje mjedisore në nivel lokal, rajonal e kombëtar. Për të arritur këtë qëllim, projekti ka pasur këto objektiva:

- 1- Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për të rritur kapacitetet e OSHC-ve mjedisore në vend;
- 2- Prezantimi i modeleve novatore në menaxhimin e mjedisit përmes një skeme gjithëpërfshirëse të nën-granteve;
- 3- Faktorizimi i kontributit të OSHC-ve mjedisore dhe rolit të advokimit në proceset e hartimit të politikave mjedisore.

Për të siguruar një menaxhim të mirë të projektit dhe një mbështetje të vazhdueshme organizatave mjedisore në Shqipëri, partnerët e projektit, për çështje menaxhimi, kanë vendosur të 'ndajnë' territorin e vendit në 4 rajone kryesore. Secili nga partnerët ka qenë përgjegjës për të ofruar asistencë dhe mentorim OSHC-ve të cilat operojnë në rajonin përkatës. Partnerët e Green-AL kanë një eksperiencë të gjatë në hartimin dhe zbatimin e projekteve mjedisore si dhe në mbështetjen e OSHC-ve në nivel lokal e kombëtar.

Rajoni qendror

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit është një organizatë jo-fitimprurëse me një përvojë të gjatë dhe një portofol të gjerë kërkimi në fushën e ofrimit të shërbimeve publike, zhvillimit rajonal, planifikimin urban, menaxhimin e mjedisit, forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe punonjësve të administratës publike, kërkimit në politika e çështje ndër-sektoriale dhe advokimit në proceset politikë-bërëse. Co-PLAN, pozicionohet midis aktorëve me ndikim, me përvojë, të mirë-formuar të Shoqërisë Civile në Shqipëri, me mbi 200 projekte zhvillimi të zbatuara, e angazhuar që nga viti 1995 për ngritjen e advokimit për çështjet mjedisore nëpërmjet dialogut sistematik me institucionet në nivel kombëtar e lokal duke ndërmarrë nisma të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit lidhur me mjedisin.

Rajoni veriperëndimor

Volontariato Internazionale per lo Sviluppo, VIS Albania/Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillim është i pranishëm në Shqipëri që nga viti 1995, me hapjen e vendit ndaj pjesës tjetër të botës. VIS Albania është një degë e *International VIS* me seli në Romë, Itali. VIS Albania është pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të OJQ-ve nga Spanja, Gjermania, Belgjika dhe Austria dhe ka qenë e vazhdon të jetë e pranishme me projekte zhvillimi në 50 vende të botës, në të gjitha kontinentet. Në kuadër të ndërgjegjësimit botëror për çështjet mjedisore, krahas arsimit, VIS po orientohet gjithnjë e më shumë në zbatimin e projekteve që synojnë ruajtjen e biodiversitetit (Amerika e Jugut) dhe zhvillimin rural (Afrikë dhe Ballkan).

Rajoni verilindor

Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli, CISP/Komiteti Ndërkombëtar për Zhvillimin e Popujve është një organizatë jo-qeveritare europiane (OJQ) e krijuar në vitin 1982 dhe e themeluar zyrtarisht në 1983. Ajo është e vendosur në Itali dhe vepron në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. CISP punon në Shqipëri që nga viti 1998. Në nivel sektorial, gjatë viteve të para të pranisë së saj në Shqipëri, CISP ka realizuar aktivitete me qëllim ndihmën humanitare dhe fushata informuese në nivel kombëtar në çështjet sociale dhe mjekësore. Kohët e fundit, një sektor i ri i ndërhyrjes është zhvillimi urban dhe menaxhimi i territorit, si dhe mbrojtja e mjedisit, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve, ndërgjegjësimin dhe informacionin për çështjet mjedisore në tërësi.

Rajoni jugor

Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario, COSV/Koordinimi i Organizatave të Shërbimit Vullnetar, është një shoqatë jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 1968, e angazhuar në zhvillim dhe ndërhyrje humanitare në Europë, Ballkan, Afrikën Jugore dhe Lindjen e Mesme. COSV operon për paqen, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit, përmes shtigjeve gjithëpërfshirëse të zhvillimit të ndërtuara mbi qasjen e partneritetit dhe rrjetëzimit, për të përmirësuar rrethanat lokale dhe për të krijuar një ndikim të provuar e afatgjatë. Puna jonë është e frymëzuar nga "kultura e bashkëpunimit" e kuptuar si solidaritet midis komuniteteve dhe është e orientuar në rindërtimin e kapitalit vendas dhe në vendosjen, përmes komuniteteve dhe në to, të marrëdhënieve të forta, për të mbështetur transformimet e rëndësishme politike dhe ekonomike në themel të zhvillimit.

Figura 1. Ndarja territoriale e vendit për qëllime menaxheriale të Green-AL



Green AL, përgjatë 2+ viteve të zbatimit të tij, ka arritur të mbështesë në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet skemave të granteve më shumë se 50 OSHC, me një shumë totale prej rreth 800,000 euro, që iu dha organizatave aplikante. Në thirrjet për projekt propozime të dy skemave të granteve të hapura në Green-AL, OSHC-të mjedisore kanë aplikuar me rreth 103 projekt-propozime nga të cilat 31 aplikime janë shpallur fituese, duke arritur të zbatojnë projektet e tyre në 25 bashki të vendit e trajtuar çështje të cilat shqetësojnë komunitetet e vogla lokale deri tek çështjet mjedisore në nivel kombëtar si ndryshimet klimatike, mbrojtja e natyrës, dhe ndotja.

Partnerët e Green-AL në bashkëpunim me organizatat përfituese të granteve kanë organizuar [5 Forume Kombëtare](#) me qëllim advokimin për çështjet mjedisore të cilat shqetësojnë komunitetet dhe janë me rëndësi kombëtare. Gjithashtu, këto organizata kanë ofruar gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në proceset e përafrimit të legjislacionit, në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian, me fokus kryesor Kapitullin 27: Mjedisori.

1. SFONDI RAJONAL

1.1 TË DHËNA GJEOGRAFIKE DHE ADMINISTRATIVE

Rajoni juglindor pozicionohet në pjesën juglindore të Shqipërisë, i kufizuar në anën lindore nga vija kufitare tokësore me shtetet fqinje: Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, në anën jugore me vijën detare të detit Jon dhe kufirin me Greqinë, në anën perëndimore me kufirin ujor të detit Jon, dhe në anën veriore me pjesën qendrore të Shqipërisë. Ky rajon përbëhet nga këto qarqe administrative:

- Qarku i Vlorës në të cilin përfshihen bashkitë Vlorë, Himarë, Selenicë, Sarandë, Delvinë, Finiq dhe Konispol;
- Qarku i Beratit në të cilin përfshihen bashkitë Berat, Ura Vajguore, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan;
- Qarku i Korçës në të cilin përfshihen bashkitë Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Maliq, dhe Pustec;
- Qarku i Gjirokastrës në të cilin përfshihen bashkitë Gjirokastrë, Dropull, Këlcyrë, Libohovë, Përmet, Memaliaj;

Ky rajon ka një pozicion gjeografik të favorshëm në Shqipëri. Në anën jugore, ai kufizohet me shtetin fqinj të Greqisë, nëpërmjet rrugëve detare (detin Jon) e tokësore në zonën e Korçës dhe Gjirokastrës. Me Maqedoninë e Veriut kufizohet nëpërmjet liqenit të Ohrit, liqenit të Prespës dhe në rrugë tokësore, ku përfshihet territor i bashkive Pogradec dhe Pustec. Në anën perëndimore të këtij rajoni shtrihen ujërat e detit Jon përgjatë të gjithë vijës kufitare.

Në këtë rajon ndodhën disa nga Qendrat Historike të vendit, të shpallura të tilla edhe nga UNESCO, të cilat janë edhe me të vizituarat në vend si : Kalaja e Gjirokastrës, Kalaja e Beratit, Parku i Butrintit, Pazari i Vjetër i Korçës, Kalaja e Lëkurësi, në Sarandë, Zona Historike e Vlorës (Shtëpia e Flamurit), Voskopoja në Korçë etj. Qyteti i Beratit dhe qyteti i Gjirokastrës janë shpallur nga UNESCO si "Qytet Muze" dhe janë të mbrojtura prej tyre. Qarqet e këtij rajoni kanë lidhje me rrugë nacionale me njëri-tjetrin, rrugë në të cilat vitet e fundit ka pasur investime si : aksi rrugor Kardhiq-Delvinë, aksi rrugor Vlorë-Llogara, rruga e re Korçë-Ersekë, etj.

Rajoni përfshin në territorin e tij numrin më të madh të zonave të mbrojtura të shpallura të tilla nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) e krijuar me VKM nr. 102, datë 04.02.2015, i cili është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura.

Zonat e mbrojtura më të rëndësishme në vend që përfshihen në këtë rajon janë:

1. Parku Kombëtar i Butrintit I cili është një nga zonat më të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore, arkeologjike, mjedisore dhe turistike. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.1.2022, Parku Kombëtar "Butrint", ka sipërfaqe 8,622.2 ha.

- Ndodhet 25 km larg qytetit të Sarandës dhe shtrihet nga brigjet e detit Jon të fushëgropës së Delvinës e deri në 825m (maja e Milesë).
2. Parku i Sazan Karaburunit është i vetmi Park Kombëtar Detar. Ky park është një pasuri e natyrës shqiptare. Ky park konsiderohet si shtëpia e 36 specieve detare me rëndësi ndërkombëtare, ku mes tyre kemi dhe specie të cilat i përkasin listave të llojeve të rrezikuara. Ekosistemi ujqor/detar “Karaburun-Sazan”, i shpallur “Park Kombëtar Detar” (kategoria II), me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.01.2022, zgjerohet nga 12,428 ha në 12,437.7 ha. Shtrihet në hapësirën detare me gjerësi 1 milje detare, përgjatë gadishullit të Karaburunit (nga kepi i Shën Vasilit deri te faqja e Langadhës) dhe rreth Ishullit të Sazanit.
 3. Parku Kombëtar i Llogarasë pozicionohet në juglindje të qytetit të Orikumit, 37 km larg qytetit të Vlorës. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.01.2022 ky park zgjerohet si sipërfaqe e ekosistemit natyror “Llogora”, shpallur “Park Kombëtar” (kategoria II), nga 1,010 ha në 1,769.2 ha. Gjendet afërsisht 40 km në juglindje të qytetit të Vlorës, në kufirin hapësinor midis detit Adriatik dhe Jon.
 4. Mali i Tomorrit është një mal i veçantë, i cili nga larg të jep përshtypjen e një kështjelle natyrore, bukuritë e të cilit janë të dukshme në çdo stinë. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.01.2022 ky park zgjerohet nga 26,106.176 në 27,158.5 ha.
 5. Parku Kombëtar i Prespës ndodhet në qarkun e Korçës. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.1.2022, ekosistemi natyror “Prespa”, Park Kombëtar, kategoria e II, ka sipërfaqen 27,613.05 ha.
 6. Ekosistemi natyror “Shebenik”, shpallur Park Kombëtar, (kategoria II), përbëhet nga një sipërfaqe prej 34,507.9 ha. Është zonë ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut, i pozicionuar në sektorin e sipërm të pellgut ujëmbledhës të lumit të Bushtricës e të Qarrishtës dhe në malet përreth tyre, në lartësitë nga 300m deri 2,261m (Maja e Rreshpës, në Shebenik).
 7. Lumi Vjosa, një nga lumenjtë e fundit të egër të Europës, është shpallur Park Kombëtar, nga Qeveria Shqiptare, duke u bërë Parku i parë Kombëtar i një lumi të egër në Europë. Në të ardhmen, Vjosa do të ruhet si një lumë natyror, me rrjedhje të lirë. Ky është rezultat i një bashkëpunimi unik midis Qeverisë Shqiptare, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, organizatave mjedisore, IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) dhe Patagonia.

Ekosistemi natyror, ligatinor “Pishë Poro-Nartë” shpallet “Peizazh i Mbrojtur”, kategoria e V (IUCN) dhe përbëhet nga dy pjesë: Pishë-Poro dhe Nartë. Akumulimi në zonën e Pishë—Poros zhvillohet në të dy anët e grykëderdhjes së kanalit kullues të Povelçës, në rreth 7 km gjatësi.

1.2 BURIMET NATYRORE

Burimet natyrore ujore në rajonin juglindor janë liqeni i Ohrit, liqeni i Prespës, liqeni i Butrintit, lumi Osum, lumi i Vjosës, lumi i Vërdovës, Përroi i Zdralit në Kolonjë, deti Jon dhe shumë burime ujore të cilat në zonë janë të shumta (shih hartën bashkëlidhur).

Një pjesë e burimeve ujore në zonë janë përdorur dhe shfrytëzuar për ndërtimin e Hec-eve për prodhim energjie, veçanërisht në vendburimet që rrjedhin nga mali i Tomorrit, Zonën e Kolonjës (Përroi i Zdrallit), Zona malore e Pogradecit etj. Një nga lumenjtë më të njohur të këtij rajoni është Osumi, i cili është degë kryesore e Semanit, i quajtur më parë edhe lumi i Beratit.

Liçeni i Ohrit, ose Liçeni i Pogradecit është një nga liçenet më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe mendohet të jetë një nga liçenet më të vjetra në botë. Ky liçen është i vendosur në një lartësi prej 695 metrash dhe ka një sipërfaqe prej 349 km². Pika më e thellë e liçenit është 289 metra. Liçeni i Ohrit është shtëpia e shumë kafshëve endemike, të cilat vijnë vetëm në ujërat e tij. Në liçen rriten 40 specie të rralla, ku ndër më të njohurat dhe ekonomikisht më të rëndësishmet është peshku i pastër i llojit *Salmo letnica*, (Korani), "*Salmothimus ohridanus*" (Belushka). Një pjesë e bregut të liçenit, së bashku me qytetin e Ohrit, janë emëruar nga UNESCO si trashëgimi botëror.

Lumi Vjosa rrjedh nga malet e Pindit në lindje të Janinës. Rrjedha e tij vazhdon në drejtim të veriperëndimit për në Shqipëri. Lumi ka një gjatësi prej rreth 272 km, prej të cilave 80 km në territorin e Greqisë, kurse rreth 192 km brenda territorit të Shqipërisë. Prurja mesatare e ujërave në grykëderdhje është rreth 204 m³/s. Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lumë i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Rajoni juglindor laget nga ujërat e detit Jon, i cili është pjesë e detit Mesdhe dhe është njëri prej dy deteve që lag brigjet e Shqipërisë. Bregdeti është i lartë, shkëmbor dhe me bukuri të shumta natyrore. Deti Jon njihet nga vozitësit e anijeve për erërat e tij të qeta. Ai është deri në 5,121 metra i thellë. Në këtë rajon, ky det lag bashkinë e Vlorës, bashkinë e Himarës dhe Sarandës

1.3 ASPEKTI SOCIAL-EKONOMIK

Ekonomia e rajonit që përfshihet në këtë projekt, si i gjithë vendi ynë, ka kaluar nëpër një proces tranzicioni, nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë.

Pjesa më e madhe e rajonit, që është një zonë bregdetare, mbështetet ekonomikisht tek turizmi, e ardhur sezonale që përfshin muajt maj – tetor. Në pjesën tjetër të vitit, vendasit mbështeten në të ardhurat që ata sigurojnë me aktivitete të tjera apo në emigracion.

Në zonat bregdetare, ku përfshihen qytetet Vlorë, Himarë, Sarandë, Ksamil dhe fshatrat që kanë lidhje të drejtpërdrejta me bregun e detit, i është dhënë përparësi investimeve në fushën e turizmit, duke u fokusuar në ndërtimin e komplekseve të banimit apo dhe turistike. Në të gjithë vijën bregdetare janë ndërtuar fshatra turistike, veçanërisht në territorin që përfshin bashkinë Himarë, Ksamil etj.

Sektori i turizmit ka qenë gjithnjë një burim i dukshëm i të ardhurave për vendin, veçanërisht gjatë muajve të verës, por kohët e fundit edhe gjatë muajve të dimrit, për shkak të rritjes së popullaritetit të sporteve të dëborës si skijimi. Në muajt e vjeshtës dhe dimrit, zona e Korçës ka përparësi turizmin pasi edhe investimet në këtë zonë janë kryesisht të lidhura me turizmin malor në Voskopojë, Dardhë dhe Moravë.

Zonat janë të pasura edhe me burime natyrore, dhe ekonomia mbështetet kryesisht në bujqësi, përpunim të ushqimit, lëndë druri, naftë, çimento, kimikate, minierat, metalet bazë, hidrocentralet, turizmi dhe industria e tekstilit.

1.4 TË DHËNA DEMOGRAFIKE¹

Statistika e popullsisë sipas bashkive për Qarkun e Korçës (sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, viti 2017) është: bashkia Pogradec 90,946 banorë, bashkia Korçë 130,390 banorë, bashkia Devoll 41,513 bashkia Kolonjë 18,720 banorë, bashkia Maliq 62,690 banorë, bashkia Pustec 5178 banorë, bashkia Pogradec 90,946 banorë.

Totali i qarkut Korçë 349,437 banorë.

Statistika e popullsisë për qarkun e Vlorës (sipas Ministrisë të Punëve të Brendshme viti 2017) është 189,039 Banorë.

Statistika e popullsisë sipas bashkive për qarkun e Beratit (sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme viti 2017) është: bashkia Kuçovë 90,946 banorë, bashkia Berat 55,293 banorë, bashkia Ura Vajgurore (Dimal) 39,551 banorë, bashkia Poliçan 18,341 banorë, bashkia Skrapar 19,072 banorë.

Qarku i Gjirokastrës ka një popullsi të regjistruar prej 156,751 banorësh, me një dendësi populsi prej 54.35 banorë për km².

Disa prej bashkive të përmendura më lart kanë aktualisht në territorin e tyre një numër të pakët banorësh. Të tilla bashki janë bashkia Pustec, bashkia Konispol dhe bashkia Këlcyrë. Kjo ka ndodhur për shkak të lëvizjes demografike të popullsisë, emigracionit apo dhe pozicionit gjeografik.

¹ <https://portavendore.al/>; Instat "Censusit të vitit 2011", INSTAT 2011

2. PALËT E INTERESUARA

2.1 AKTIVITETET E PROJEKTEVE


Në kuadër të projekteve të zhvilluara në rajonin jugor, të cilat siç e përmendëm edhe më lart përfshijnë qarkun e Vlorës, të Beratit, qarkun e Korçës dhe Gjirokastrës, janë mbajtur:

- 9 takime prezantuese, informuese dhe përmbyllëse me të gjitha palët e interesuara në projekte si dhe me përfaqësues të bashkive apo me organizata aktive për forcimin e bashkëpunimeve dhe sinergjive me aktorë të ndryshëm;
- 2 vizita studimore brenda dhe jashtë vendit për të marrë njohuri mbi praktikat më të mira të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura;
- 2 trajnime, të zhvilluara kryesisht me palë të interesuara të komunitetit për mbrojtjen e natyrës si dhe për promovimin e formave të turizmit të qëndrueshëm;
- 7 aktivitete ndërgjegjësimi/advokimi dhe edukuese me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve për problemet mjedisore, shpjegimin e situatës së ndotjeve nënujore dhe bregdetare, nxitjen e ndjesisë së vullnetarizmit tek këta të rinj, si dhe promovimi i zonave të cilat janë subjekt projektesh me synim mbrojtjen e ekosistemeve dhe promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore;
- 8 aktivitete vullnetare në terren me disa rezultate konkrete:
 - Mbjellja e 460 fidanëve të dafinës, si bimë e zonës, për rivendosjen e ekuilibrave ekologjikë në ekosistemin e dëmtuar nga guroret në Himarë;
 - Mbjellja e 350 fidanëve të pishës së butë dhe 1,250 fidanëve në bashkinë Berat;
 - Largimi i 270 gomave dhe mbetjeve plastike në tabanin e detit Jon në Sarandë;
 - Ndërgjegjësimi i turistëve mbi ndotjen bregdetare dhe mjedisive të pastra;
 - Pastrimi nga ndotja e dy lumenjve në bashkinë Pogradec;
 - Dekorime me temën të biodiversitetit të zonës së Zvërnecit, për të rritur ndërgjegjësimin publik për rëndësinë e Zonave të Mbrojtura;
- Hartimi i një dokumenti politikash "Aspektet natyrore dhe ndikimi antropogjen në Peizazhin e Mbrojtur 'Vjosë-Nartë' .
- Përgatitja e materialeve informuese dhe shkencore — 3 tabela informuese, brenda territorit të zonës së mbrojtur PM Vjosë-Nartë si dhe 1 *roll-up* statik në mjedis publik me mesazh ndërgjegjësimi për kujdesin ndaj ndotjes detare.



E veçanta në këto projekte ishte trajtimi i gjerë i aktivitetit për pastrimin e plazhit si dhe nxjerrjen e gomave nga deti Jon në zonën e bashkisë Sarandë në minutazh televiziv dhe rrjete sociale.

Grafiku nr. 1. Aktivitetet e zhvilluara në projektet e rajonit jugor.



2.2 PJESEMARRJA NË PROJEKTE

Projektet e rajonit jugor kanë mbledhur një numër të lartë të aktorëve lokalë të cilët janë angazhuar në projektet mjedisore të këtij rajoni. Më konkretisht, kanë marrë pjesë 949 përfaqësues nga:

- Qeverisja vendore (42)
- Aktorë partneriteti (132)
- Komuniteti (banorë të zonave përkatëse; studentë; gjimnazistë (660)
- Eksperte të fushës
- Organizata jo-qeveritare (50)

Vlen të theksohet se grupi kryesor i synuar i këtyre projekteve kanë qenë gjimnazistët dhe studentët të cilët u përfshinë jo vetëm për të promovuar dhe ndërgjegjësuar për mbrojtjen e mjedisit, por dhe për krijimin e kulturës së ruajtjes së natyrës.

Grafiku nr. 2: Pjesëmarrja e aktorëve kryesore në aktivitetet e zhvilluara në projekte





Figura 2: Qyetet e rajonit jugor



Burimi: Autoret, Co-Plan 2022

3. PROJEKTET E ZBATUARA

3.1 PROJEKTI: EKOMUZEUMI I ZVËRNECIT "NJË INSTRUMENT PRAKTIK PËR PROMOVIMIN E NATYRËS, KULTURËS DHE AVENTURËS NË PEIZAZHIN E MBROJTUR VJOSË-NARTË"

Shoqata: "Për Turizmin e Qëndrueshëm dhe Kërkimin Mjedisor" (ASTER)

Njësia administrative: Novoselë, Bashkia Vlorë

Shqipëria është një vend me shumëllojshmëri të lartë biologjike, por paraqet vështirësi të konsiderueshme në menaxhimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së tij natyrore. Vitet e fundit, pas presionit dhe rritjes së vëmendjes ndaj çështjeve mjedisore, janë kryer ndërhyrje të shumta, duke përfshirë rritjen e sipërfaqeve zonë e mbrojtur dhe prezantimit të konceptit të rritit *Natura 2000* për të harmonizuar politikat shqiptare të mbrojtjes me ato europiane. Peizazhi i Mbrojtur "Vjosë-Nartë", i ndodhur në qarkun e Vlorës brenda

territorit të bashkisë Vlorë në njësitë administrative (ish-komunat) Novoselë dhe Qendër, është një zonë e njohur për shumëllojshmërinë e habitatit. Kjo zonë është një kompleks ligatinor që shtrihet në afërsi të grykëderdhjes së lumit Vjosë e në jug të tij. Disa prej mjedisëve kryesore të ZM Vjosë-Nartë janë ligatinat, tokat bujqësore, pyjet dhe zonat urbane. Sipërfaqja ligatinore zë 37% të sipërfaqes së përgjithshme. Sipërfaqja e dytë për nga madhësia është toka bujqësore që zë afro 33% të sipërfaqes. Pyjet përbëjnë habitatin e tretë dhe mbulojnë 6% të territorit. Në këtë zonë gjenden disa lloje të rralla për Shqipërinë, të tjera kanë vlerë të rëndësishme shkencore dhe një numër i lartë specimesh përdoren gjerësisht në ekonomi si bimë mjekësore, aromatike, industriale dhe zbukuruese. Peizazhi i Mbrojtur njihet edhe për shpendët tipik ligatinor të ekosistemeve si ato të kallamishteve, kënetave, pyjore për sigurimin e ushqimit dhe duke shërbyer si një zonë mjaft e rëndësishme për folezimin e tyre. Më shumë se 88 lloje gjenden në këto habitate.

Kompleksi ligatinor i Nartës është i famshëm edhe për dunat e tij ranore bregdetare disa prej të cilave arrijnë 6 – 8 metra. Kjo zonë po haset me sfida të ndryshme mjedisore që lidhen ngushtësisht me presionin antropik gjithnjë e në rritje, me pasojat e ndryshimit klimatik që kanë sjellë specie invazive mbizotëruese në brendësi të saj dhe erozion të vazhdueshëm të brigjeve të saj. Megjithatë, rreziku më i madh që i kanoset lidhet me ndërtimin e Aeroportit të Vlorës në pjesën e saj veriore që minon në mënyrë të konsiderueshme korridorin natyror të shpendëve shtegtarë që përshkojnë itinerarin Afrikë—Siberi e që kalojnë po në këtë thesar nga pikëpamja e larmishmërisë natyrore dhe biodiversitetit. Nga ana tjetër, peizazhi delikat i Vjosë-Nartës po kthehet në një destinacion të frekuentuar nga një turizëm me rritje të vazhdueshme i cili përqendrohet kryesisht tek Manastiri i Shën Marisë me vendndodhje në fshatin Zvërnec. Po në afërsi të këtij objekti fetar e kulturor, ndodhen në gjendje harrese 4 bunkerë-galeri me funksione ushtarake, të realizuar në vitet 70 nga regjimi socialist i kohës. Duke konsideruar premisat e mësipërme dhe problematikat e identifikuar, konsorciumi i përbërë nga subjektet CERCI-Edukim Komunitar për të Drejta Kulturë Integrim, ASTER, *Vjosa Explorer* dhe bashkia Vlorë kanë ideuar dhe zhvilluar projekt propozimin: Eko-muzeu i Zvërnecit: një instrument praktik për promovimin e natyrës, kulturës dhe aventurës në Peizazhin e Mbrojtur “Vjosë-Nartë”. Ky projekt synon të adresojë në mënyrë të shumanshme nëpërmjet një modeli novator, disa problematika qenësore të listuara më sipër në sektorin e mjedisit dhe biodiversitetit në Shqipëri, duke kombinuar qasjen e turizmit të qëndrueshëm me nevojën për mbrojtjen e kapitalit natyror.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është kontributi në zhvillimin e shërbimeve eko-mjedisore për mbrojtjen e biodiversitetit në Shqipëri. Ky qëllim është synuar të arrihet nëpërmjet ndërthurjes së komponentit të investimit në aksesin infrastrukturor, zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe cilësisë së materialit shkencor e zbulimor. Objektivi specifik i projektit synon rritjen e ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e ekosistemeve dhe promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë”, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të ndryshme komunitare, realizimit të fushatave ndërgjegjësuese në terren, dhe në planin teorik.

Projekti u realizua në partneritet me institucionet shkencore, kërkimore dhe shoqërinë civile. Partnerë të shumtë e kanë mbështetur projektin dhe u bënë pjesë e realizimit të

eko-muzeut si : administrata e bashkisë Vlorë, Prefektura, Këshilli i Qarkut, Universiteti i Vlorës, gjimnazi “Ali Demi” ADZM Vlorë, Qendra e Edukimit Profesional, Gjelbërimi 2000, CELIM dhe vullnetarë. Ky bashkëpunim duhet të vazhdojë me të njëjtën forcë, edhe në të ardhmen e këtij eko-muzeu.

Rezultati i parë i projektit është konceptuar për t'iu përgjigjur nevojës për të zgjeruar kapacitetet dhe strukturat promovuese të Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë” ndërsa rezultati i dytë synon të ndikojë në mënyrë cilësore dhe sasiore në rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurisë teknike mbi vlerat natyrore të këtij peizazhi, falë një bashkëpunimi të efektshëm me aktorët e partneritetit dhe grupeve të synuara. Në përfundim, falë rezultatit të tretë, projekt konsorciumi pret të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të promovimit të Peizazhit të Mbrojtur, nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të ndryshme të vizibilitetit si dhe fushatave të komunikimit. Të gjitha rezultatet e listuara janë të lidhura në mënyrë harmonike dhe kontribuojnë në objektivin specifik të ndërhyrjes së propozuar. Si pjesë e konsorciumit për zbatimin e projektit, shoqata “Për Turizmin e Qëndrueshëm dhe Kërkimit Mjedisor (ASTER)” është fokusuar në realizimin e aktiviteteve në kuadër të komponentit 2, i cili ka synuar të ndikojë në mënyrë cilësore dhe sasiore në rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurisë teknike mbi vlerat natyrore të Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë”, të përshkruara shkurtimisht si më poshtë:

1. Në prill 2022 u realizua një vizitë studimore në Taranto, Vizita studimore u realizua në eko-muzeun e "Palude la Vela e Mar Piccolo", në Taranto të Italisë.

Qëllimi i përgjithshëm i vizitës studimore ishte krijimi i mundësive për përfaqësuesit e Bashkisë Vlorë, AdZM Vlorë dhe organizatave të shoqërisë civile vendase, në cilësinë e partnerëve dhe aktorëve të menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë” për të marrë njohuri mbi praktikat më të mira të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe modelin e eko-muzeut në natyrë, të përfaqësuar nga eko-muzeu i "Palude la Vela e Mar Piccolo".

Figura 3: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata ASTER





Figura 4: Vizitë studimore në Eko-muzeun e "Palude la Vela e Mar Piccolo"



Për më tepër, vizita studimore kishte për qëllim forcimin e partneritetit të krijuar midis bashkisë Vlorë, AdZM Vlorë dhe organizatave të shoqërisë civile, duke përforsuar

bashkëpunimin dhe përfshirjen e aktorëve në ngritjen dhe menaxhimin e eko-muzeut të Zvërnecit dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me homologët italianë të komunës së Tarantos dhe WWF Taranto. Vëmendje e veçantë iu kushtua përzgjedhjes së vendeve që u vizituan për të ofruar përvojat më të përshtatshme dhe shembujt praktikë mbi qasjen e zbatuar për menaxhimin e eko-muzeut.

Figura 5: Vizitë studimore në Eko-muzeun e "Palude la Vela e Mar Piccolo"



Burimi: Shoqata CERCI

2. U organizua një trajnim 2-ditor me guidat vendase mbi qasjen eko-muzeale dhe promovimin territorial" Ky trajnim forcoi kapacitetet dhe strukturat në ofrimin e shërbimeve eko-mjedisore duke ndërthurur mbrojtjen e natyrës me promovimin e formave të turizmit të qëndrueshëm në Peizazhin e Mbrojtur "Vjosë-Nartë".

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të guidave turistike lokale dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Vlorë për njohjen e vlerave natyrore të Peizazhit të Mbrojtur "Vjosë-Nartë", format alternative eko-turistike në zonë, shtigjet natyrore dhe aspektet historike dhe kulturore të zonës si dhe përcjelljen e instrumenteve kryesorë të promovimit të eko-muzeut dhe njohuritë specifike mbi promovimin territorial të fituara gjatë vizitës studimore në Itali.

Figura 6: Vizitë studimore në Eko-muzeun e Zvërnecit



Burimi: Shoqata CERCI

Shoqata ASTER organizoi këtë trajnim dy-ditor me qëllim rritjen e kapaciteteve të guidave lokale natyrore për ushtrimin e aktivitetit në drejtim të ego-turizmit natyror me bazë zonat e mbrojtura si dhe për të diskutuar mundësitë e komunikimit e bashkëpunimit të aktorëve lokalë, që janë të interesuar për ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe nxitjen e turizmit të qëndrueshëm të një zone të mbrojtur.

Figura 7: Trajnim dy-ditor nga Shoqata ASTER me qëllim rritjen e kapaciteteve të guidave



Burimi: Shoqata ASTER

3. Realizimi i një dokumenti politikash mbi territorin natyror dhe presionin antropik në lagunën e Nartës. Dokumenti i politikave mbi Vjosë-Nartën, si zonë e mbrojtur e kategorisë së V, ka sjelle informacione lidhur me përshkrimin e zonës së mbrojtur, vlerat natyrore, historike dhe kulturore që ajo ka; lista e specieve me rëndësi kombëtare; presionet dhe ndikimet negative që aktivitetet antropogjenike sjellin mbi biodiversitetin e zonës si dhe

masat e domosdoshme që duhen ndërmarrë lidhur me sigurimin e ruajtjes së këtyre habitateve me rëndësi kombëtare dhe të përfshira në listën e habitateve me rëndësi natyrore të Bashkimit Europian.

Në këtë dokument politikash përshkruhet prezenca dhe shpërndarja e specieve me rëndësi kombëtare, duke kushtuar një vëmendje të veçantë ndaj presioneve që mund të vijnë nga faktorë si natyrorë ashtu edhe antropogjenikë ndër të cilët përmendim: zjarret (zona në të cilën është gjetur specia është një zonë e prekur nga zjarri i ndodhur rreth 2 vite më parë dhe në rast të përsëritjes së dukurive të tilla, është nën ndikimin e drejtpërdrejtë të tij). Janë zhvilluar 2 vizita në terren gjatë së cilave është studiuar shpërndarja gjeografike e species dhe marrja e koordinatave në zonat ku ajo ka qenë e pranishme.

Ky aktivitet kishte si qëllim mbledhjen e të gjitha informacioneve mbi speciet, habitatet dhe zonat me rëndësi natyrore dhe rolin e tyre në ekosistemin ku ndodhen. Rreth 45 specie dhe habitate po vlerësohen përgjatë këtij projekti dhe do të përgatitet informacione për secilën prej tyre.

Ndër speciet me rëndësi për Peizazhin e Mbrojtur "Vjosë-Nartë" janë shpendët folenizues të lagunës, breshkat e detit folenizuese si dhe gjitarët me status mbrojtjeje. Ndër to përmenden: breshkat e detit, ku lloji *Caretta* është një ndër speciet detare të cilat prej një viti janë konfirmuar si folenizuese në zonën bregdetare dhe detit Adriatik, përkatësisht në dunat e Nartës. Ky studim do të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2023.

Figura 8: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata CERCI



Ndër shpendët karakteristikë ujore, për të cilët laguna e Nartës përbën dhe habitatin kryesor të folezimit të tyre është kalorësi i njohur me emrin shkencor *Himantopus himantopus*, Sqepbiza (*Recurvirostra avossetta*), gjelaci symadh (*Burhinus oedicanus*), dallëndyshja ballëbardhë e detit (*Sternula albifrons*) etj. Ndër gjitarët me rëndësi dhe të rrallë janë lakuriqët e natës.

Ndër habitatet me rëndësi kombëtare përmendim: Dunat e Nartës të cilat luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në folezimin e breshkave të detit, kallamishtet si zona me rëndësi për shpendët e kallamishteve dhe kanalet/pellgjet ku kemi prezencën e bretkosës endemike shqiptare e njohur me emrin shkencor *Pelophylax shqipericus* si dhe breshkën e ujërave të ëmbla mjaft e rrezikuar në Shqipëri dhe e prekshme nga ndryshimet klimatike e njohur me emrin shkencor *Emys orbicularis*.

Figura 9: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata CERCI



4. Përgatitja e materialeve informuese dhe ndërgjegjësuese: Realizimi i dizajnit si dhe printimi i 3 tabelave informuese, të cilat u vendosën brenda territorit të zonës së mbrojtur PM Vjosë-Nartë. Modeli i tabelave dhe ndërtimi i informacionit është përgatitur bazuar në standardin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Është përfshirë harta që të çon tek eko-muzeu i Zvërnecit, si dhe informacione lidhur me vlerat natyrore dhe historike të zonës. Këto tabela do të shërbejnë si për të drejtuar vizitorët drejt eko-muzeut

të Zvërnecit, por në të njëjtën kohë përcjellin informacion për vlerat e zonës dhe kodin e sjelljes së vizitorëve në zonë.

Figura 10: Peisazhi i Mbrojtur Vjosë- Nartë Burimi: Shoqata ASTER



Qëllimi i vendosjes së këtyre tabelave është jo vetëm për udhëzimin e vizitorëve drejt eko-muzeut të Zvërnecit, por në të njëjtën kohë informimin e tyre mbi vlerat natyrore dhe historike të zonës. Vizitorët kanë mundësi të informohen edhe për aktivitetet të cilat realizohen në këtë zonë. Gjithashtu, në tabela është vendosur edhe kodi i sjelljes që vizitorët duhet të zbatojnë.

5. Krijimi i materialeve shkencore-informuese mbi speciet endemike dhe karakteristikat etnografike të zonës. Realizimi i shërbimit audio-vizual, i cili do të shërbejë brenda muzeut.

Ky aktivitet ka si qëllim mbledhjen e të gjitha informacioneve dhe fotove të përshtatshme mbi speciet, habitatet dhe zonat me rëndësi natyrore dhe rëndësinë që ato kanë në ekosistemin ku ndodhen. Përgjatë këtij projekti u vlerësuan specie dhe u përgatit informacion mbi llojet më të rëndësishme dhe karakteristike të zonës.

Janë zhvilluar gjithashtu takime në terren, ku janë mbledhur informacione për trashëgiminë kulturore. Informacioni është mbledhur nga botimet lokale dhe nëpërmjet hulumtimit në terren. Duke qene se për zonën e Zvërnecit nuk ka shumë të dhëna specifike, atëherë për këtë arsye u zgjerua zona e mbledhjes së të dhënave duke përfshirë edhe Nartën dhe rrethinat e tjera të qytetit të Vlorës.

Janë përgatitur materiale divulguese-shkencore mbi speciet me rëndësi në peizazh dhe është realizuar një material audio-vizual, i cili do të shërbejë brenda muzeut për prezantimin e vlerave të zonës.

Shoqata: "CERCI"

Njësia administrative: Novoselë

Bashkia: Vlorë

Rezultati i parë i projektit i zbatuar nga shoqata Cerci u konceptua për t'iu përgjigjur nevojës për të zgjeruar kapacitetet dhe strukturat promovuese të Peizazhit të Mbrojtur "Vjosë-Nartë". Në kuadër të këtij projekti u organizuan një sërë aktivitetesh.

1. *Konceptimi teknik dhe shkencor i eko-muzeut.* Aktiviteti u organizua si nevojë e vlerësimit të punës së kryer dhe zgjerimit të mundësive të reja. Specialiste në fushën e mjedisit sollën përvojën për ndërtimin e një impianti të qëndrueshëm në prezantimin e biodiversitetit dhe ofrimin e shërbimeve mjedisore. Gjithashtu, u bë dhe shkëmbimi i përvojave më të mira të fushës. Specialistet dhanë rekomandime për ndërtimin e një formati social dhe mjedisor si dhe u sugjerua rritja e dukshmërisë së shërbimeve eko-mjedisore dhe kujdesi ndaj një zhvillimi të qëndrueshëm.

Figura 11: Konceptimi teknik dhe shkencor i eko-muzeut Burimi: Shoqata CERCI



3. Gjate muajit prill 2002, u kryen dekorimet e fasadave te bunkerëve me murale nga piktorët Harilla Ibrahimimi dhe Franko Dinaj.

Franko Dinaj prezantoi teknikat më të mira të artit urban në raport me peizazhin si dhe materialet që sugjerohet të përdoren duke marrë parasysh afërsinë e bunkerit me detin. Harilla Ibrahimimi foli për mundësinë e restaurimit dhe ruajtjes së shkrimeve historike e në raste të veçanta dhe për t'i përsëritur ato. Në pjesën balllore të bunkerëve po realizohen dekorime me temën e biodiversitetit të zonës së Zvërnecit, për të rritur ndërgjegjësimin publik për rëndësinë e zonave të mbrojtura. Janë bërë murale me shpendë, kafshë dhe specie të tjera të zonës. Muralet e prezantuara janë vendosur në raport me natyrën dhe historinë e ndërtimit të bunkerëve. U bë kujdes që harmonia e ngjyrave t'u përshtatet specieve dhe mjedisit ku ato jetojnë.

Pamjet me murale synojnë t'u drejtohen të rinjve, qytetarëve, studentëve, shkollave dhe vizitorëve të huaj te cilët përshkojnë itinerare të reja *outdoor* përmes kulturës dhe natyrës.

Figura 12: Konceptimi teknik dhe shkencor i eko-muzeut Burimi: Shoqata CERCI



4. Stafi drejtues i projektit organizoi një takim në terren me ekspertë të fushave për rehabilitimin e Bunkerit-Fjetinë si dhe për të vlerësuar idetë promovuese për përvojat më të mira. U diskutua për krijimin e grupeve të punës dhe forumet e përbashkëta me banorët vendas, çka do të stimulojë në këtë kontekst, ndryshime pozitive sociale dhe mjedisore. Prania e specialistëve: Edmond Beqiri, Eneida Haskaj, Ina Nasto, Bojken Sinaj, Rezart Sulejmani solli në vëmendje teknika interesante për ndërtimin dhe pajisjet eko-muzeore.

Figura 13: Konceptimi teknik dhe shkencor i eko-muzeut Burimi: Shoqata CERCI



Në Ditën Botërore të Mjedisit, me grupin e Natyralistëve të qytetit, u organizua vlerësimi i peizazhit. Ky aktivitet synoi të shpjegonte në mënyrë më të qartë biodiversitetin, duke e bërë më të lexueshëm dhe të qashtë për të rinjtë, banorët, turistët dhe vizitorët. 30 natyralistët e rinj, nxënës të gjimnazeve të qytetit e studentë vizituan Bunker-Galeritë, muralet dhe peizazhin mahnitës. U njohën me natyrën, historinë dhe trashëgiminë e zonës së Zvërnecit. Me pjesëmarrësit u organizua gjithashtu edhe grumbullimi i mbetjeve plastike, të cilat u transportuan në pikat e grumbullimit të mbetjeve.

Figura 14: Vizitë studimore në Eko-muzeun e Zvërnecit





Burimi: Shoqata CERCJ

6. Aktiviteti "Komuniteti dhe Peizazhi" u zhvillua në "Kraal Hotel" gjatë muajit korrik 2022, ku morën pjesë 45 pjesëmarrës si pedagogë, studentë të Universitetit "Ismail Qemali", përfaqësues të OJF-ve, banorë të zonës së Zvërnecit si dhe operatorë turistikë të njësive administrative. U vlerësua lindja e nismës modeste në një mjedis me potencial të veçantë, ku synimi është kontributi në angazhimin e përbashkët të komunitetit në rritjen e qëndrueshmërisë vendore, ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e imazhit të Vlorës. Gjithashtu, u diskutua për asetet e braktisura të zonës, të cilat me pak investim mund të kryejnë funksione të reja dhe promovuese të territorit. U vlerësua infrastruktura turistike dhe kapacitetet e agjentëve lokalë të zhvillimit dhe promovimit më tej tek publiku i gjerë. Veçanti e këtij projekti ishin bashkëpunimi i aktorëve me bashkinë e Vlorës dhe komunitetin.

7. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbrojtjen e natyrës u bë përmes promovimit të imazhit të eko-muzeut. Në këtë aktivitet mori pjesë, Z. Dritan Leli, kryetari i Bashkisë, i cili vlerësoi bashkëpunimin dhe partneritetin gjatë etapave të zhvillimit të projektit. U prezantuan 50 tabela për biodiversitetin e zonës, të cilat do të riprodhohen edhe në gjuhën angleze për turistët që vizitojnë zonat turistike të Zvërnecit.

Gjatë këtij aktiviteti, u ndanë praktikat e mira për realizimin e eko-muzeve nga Z. Marko Madano, drejtor për zonat e mbrojtura në bashkinë e Tarantos, Itali. Në aktivitet u prezantua projekti i restaurimit të sallës dhe studimi arkitekturor i eko-muzeut. Operatorët turistikë folën për mundësitë e bashkëpunimit për të krijuar një turizëm tërheqës duke nënvizuar faktin se mungojnë axhendat dhe guidat turistike të mirëfillta për këtë zonë.

Figura 15: Aktiviteti “Komuniteti dhe Peizazi”



Burimi: Shoqata CERCI

8. Në nëntor 2022 u organizua promovimi i një imazhi të ri të eko-muzeut të Zvërnecit, ku pati pjesëmarrje të shumë aktorëve partnerë, institucione, nxënës të komunitetit, shoqatat zbatuese Cerci, Aster, Vjosa Explorer, përfaqësues të AdZM-së dhe Klubi Ekologjik.

Sipas axhendës së miratuar, u realizuan veprimtari të cilat ndoqën njëra-tjetrën. Cerci përgatiti dhe siguroi pjesëmarrjen e natyralistëve të Klubit Ekologjik, por kësaj here me tjetër tematike, e filluar që në muajin shtator. Me grupe të vogla nxënësish u prezantua ideja e krijimeve në vizatim dhe pikturë e pamjeve të ishullit të Zvërnecit, Lagunës, Manastirit të Zvërnecit dhe Bunker-Galerive.

Nxënësit sollën 25 punime ku, përveç tematikës së peizazhit, ata trajtuan temat e flamingove dhe shpendëve të tjerë, si përshtypje të mbledhura pas vëzhgimit në terren. Këto punime u shpалosën në mjediset e urës së Manastirit dhe të Bunker-Galerive. Nxënësit u njohën me rëndësinë e zonave të mbrojtura, ruajtjen e biodiversitetit të zonës dhe rëndësinë e këtij eko-muzeut. Ata u përgëzuan për punimet e bukura dhe u nxitën për të vazhduar edhe në të ardhmen të punojnë këto krijime për natyrën. Pas kësaj, nxënësit përshkuan me këmbë urën e Manastirit, duke shoqëruar aktivitetin e biçikletave deri tek Bunker-Galeritë, ku dhe u njohën me tabelat informuese.

Figura 16: Promovimi i një imazhi të ri të eko-muzeut të Zvërnecit



Burimi: Shoqata CERCI



Shoqata Vjosa Explorer

Roli i shoqatës Vjosa Explorer në këtë projekt lidhet me temën e mbrojtjes së natyrës dhe me promovimin e formave të turizmit të përgjegjshëm në Peizazhin e Mbrojtur “Vjosë-Nartë”, në zonën e Vlorës. Kompleksi “Vjosë-Nartë” është një zonë e mirënjohur për florën e veçantë dhe larminë e habitateve. Për këtë, kjo zonë është klasifikuar si zonë e rëndësishme për zogjtë dhe bimët në nivel ndërkombëtar. Vjosë–Narta strehon 26 lloje globalisht të rrezikuara dhe si e tillë, është një zonë ruajtja e së cilës ka një interes mbarë botëror. Përveç kësaj, kompleksi regjistron 189 lloje të rrezikuara në Shqipëri, fakt që e rendit atë në një zonë të vyer e cila meriton të ruhet me kujdes. Rëndësia e zonës tregohet gjithashtu nga prania e 118 llojeve të mbrojtura në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesë e këtij peizazhi është edhe lumi Vjosa, lumi i vetëm i egër i mbetur në Europë. Ai është pjesë e rëndësishme e Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë” dhe grykëderdhja e tij nuk përbën vetëm një bukuri natyrore ku mund të shijohen flora dhe fauna e pasur, por mundëson edhe realizimin e sporteve ujore siç është rafting. Kjo është

një mënyrë e re për diversifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe një atraksion turistik i shtuar në Peizazhin e Mbrojtur “Vjosë-Nartë”.

Në korrik 2022, Shoqata Vjosa Explorer në bashkëpunim me partnerët e saj organizoi aktivitetin e projektit “Rafting në lumin Vjosa”. Ky aktivitet u realizua për herë të parë në grykëderdhjen e lumit Vjosë dhe bëri bashkë institucionet publike, shoqërinë civile, dhe aktorët lokale, me fokus kryesor promovimin e zonës dhe shtimin e ofertës turistike që ky peizazh ofron. Tashmë, jo vetëm në luginën e sipërme të lumit Vjosa, por edhe në grykëderdhjen e saj mund të zhvillohen aktivitete sportive ujore si rafting. Kjo do jetë një mënyrë e re e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe një atraksion turistik më shumë në këtë zonë. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, përfaqësues të Co-PLAN, UNDP ALBANIA, NATGA, COSV, organizata rurale, organizata *Reality Escaper* AI, Adzm Vlorë, shoqata Aster, shoqata Cerci, ekspertë të jashtëm dhe vullnetarë.

Figura 17: Rafting në lumin Vjosa



Burimi: Shoqata Vjosa Explorer

Në nëntor 2022, Vjosa Explorer në bashkëpunim me partnerët e saj organizoi aktivitetin outdoor “Ecobike”. Ecobike është një aktivitet që ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Peizazhin e Mbrojtur “Vjosë-Nartë”. Aktiviteti ishte programuar dhe filloi në qendrën e Agjencisë së Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura ku u krye dhe një prezantim për aktivitetin e organizuar nga shoqata Vjosa Explorer dhe partnerët. Rruga deri drejt eko-muzeut të Zvërnecit u përshkrua nëpërmjet pyllit të Sodës ku u mundësuan edhe ndalesa tek tabelat informuese që partnerët e Aster kanë vendosur në kuadër të këtij projekti për të bërë të mundur edhe diskutimin me pyetje-përgjigje të të ftuarve.

Vizita në Manastirin e Zvërnecit bëri të mundur që të pranishmit të vizitojnë ekspozitën e vizatimeve me tematikë natyrën nga Klubi i Ekologjistëve si dhe vëzhgimin e faunës që të ofron laguna e Nartës. Fjala përshëndetëse e të ftuarave dhe prezantimi i doracakut

(broshurë) nga ana e shoqatës Vjosa Explorer u bë në eko-muzeun e Zvërnecit, konkretisht tek bunkerët e Zvërnecit. Në aktivitet morën pjesë: Prefektura, Universiteti i Vlorës, Adzm Vlorë, shoqata Aster, shoqata Cerci, ekspertë të jashtëm, vullnetarë.

Figura 18: Aktiviteti outdoor "Ecobike"



Burimi: Shoqata Vjosa Explorer

PËRFUNDIME

- Në këtë projekt u realizuan aktivitete *outdoor* me itinerare turizmi eko-mjedisor, *rafting* në lumin Vjosa dhe *mountain bike* në Peizazhin e Mbrojtur të Nartës me aktorët lokalë dhe institucionet publike.
- E veçanta e këtij projekti ishte një video-promovuese, e cila u prezantua dhe u publikua në televizionin kombëtar RTSH si dhe u publikua në rrjetet sociale të shoqatave që realizuan këtë projekt.
- U realizua broshurë (doracaku) (Vjosë-Nartë Explorer) me hartën dhe itineraret kulturore e natyraliste të eko-muzeut, e printuar në 100 kopje. Në aktivitetin e kryer në kuadër të këtij projekti, anëtarët e shoqatës e kanë shpërndarë dhe prezantuar atë tek të pranishmit. Pjesa tjetër e broshurave janë dorëzuar tek organizata udhëheqëse e këtij projekti, shoqata Cerci.
- Zhvillimi i takimeve në forma të ndryshme si për shembull duke bërë *rafting* në lumin Vjosë apo *mountain bike* në peizazhin e mbrojtur të Nartës me pjesëmarrësit në këto aktivitete është risi.

3.2 PROJEKTI ZHDUKJA E EKOSISTEMEVE NGA AKTIVITETI I MINIERAVE TË GURIT

Shoqata: Vizioni i Gjelbër

Bashkia: Himarë

Bashkia e Himarës përfshin, në pjesën më të madhe të saj, territor bregdetar dhe ka si fokus parësor investimet në fushën e mjedisit. Por, një pjesë e territorit të kësaj bashkie

është shfrytëzuar edhe për aktivitete minerare siç është rasti i fshatit Vranisht. Banorët e këtij fshati kanë ngritur shqetësime që lidhen me aktivitetin e disa minierave të nxjerrjes së gurit në këtë zonë. Aktiviteti i të filla guroreve në zona të njohura si kurora të gjelbra apo edhe pyjore ka shkatërruar kullotat, është shoqëruar me prerje masive të pemëve, gjë e cila ka sjellë zhveshjen e malit dhe si pasojë në këtë zonë vërehet aktivitet erozioni i tokës. Faktorët e mësipërm sjellin dëme në bagëti dhe bujqësi si edhe përdorim në sasi të madhe të kimikateve të rrezikshme për natyrën, për bagëtitë dhe ujërat e burimeve nëntokësore.

Shoqata kreu verifikime dhe vëzhgim të situatës në terren gjatë së cilave u konstatua tjetërsimi i peizazhit natyror, maleve dhe zhdukje të ekosistemeve. Fotoja e mëposhtme pasqyron më së miri këto fenomene.

Figura 19: Bashkia e Himarës




Burimi: Shoqata Vizioni i Gjelbër

Në bazë të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" kompanitë e guroveve kanë detyrimin ligjor që, me fondet e tyre, të bëjnë një rehabilitim progresiv të natyrës që ata kanë dëmtuar deri edhe në masën 100%. Legjislacioni përcakton qartë se hartimi i planit të rehabilitimit dhe rehabilitimi progresiv nga këto kompani duhet të fillojë që në vitin e parë pas shfrytëzimit të saj (pika 8, urdhër nr. 67, datë 11.3.2018). Kompanitë janë të detyruara me ligj që të kompensojnë këto dëme, por zbatimi i ligjit dhe monitorimi mbeten gjithmonë pika më e dobët.

Nga vëzhgimet u konstatua se në zonë nuk është kryer asnjë rehabilitim. Për rrjedhojë, ndikimi në shëndetin e njerëzve, peizazh, florë dhe faunë është i ndjeshëm dhe afatgjatë.

Figura 20: Guoret në Vranisht, Vlorë



Burimi: Shoqata Vizioni i Gjelbër

Mungesa e rehabilitimit të mjedisit të dëmtuar nga guoret në zonën e Himarës është i qartë dhe mbetet një ndër pikat më problematike të guroveve megjithëse, siç e theksuam edhe më lart, është detyrim ligjor. Ky fenomeni i mungesës së rehabilitimit është përmendur në vitin 2018 edhe nga përfaqësues të Kryeministrisë dhe kjo dëshmon se të gjithë palët janë të dëmtuara nga moszbatimi i detyrimeve ligjore të guroveve. Veprimtaritë e guroveve kanë ndikim në mjedis për efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, dhe trashëgiminë kulturore.

Projekti filloi me grumbullimin e dokumentacionit që lidhet me aktivitetin e guroveve të synuara.

1. Pas grumbullimit të dokumentacionit, institucioneve lokale iu dërguan komunikime zyrtare për të realizuar një monitorim sa më të saktë dhe me qëllim arritjen e përfundimeve të sakta. Këto shkresa iu drejtuan bashkisë Himarë, Drejtorisë rajonale Tatimore Vlorë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencive Rajonale të Mjedisit

të Fierit, Vlorës e Gjirokastrës, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Nga monitorimi në terren i aktivitetit të shfrytëzimit të pasurive natyrore të këtyre guroreve u evidentua se është dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme mjedisi natyror, toka përreth tyre, struktura dhe pjelloria e saj, vegjetacioni, flora dhe fauna e zonës përreth, cilësia e ujërave dhe ajrit. Gjithashtu, janë shkaktuar shpërthime, zhurma dhe pluhura, janë zhvendosur gurë dhe masivë inertesh drejt tokave dhe lumit të cilët kanë ndikuar në uljen e cilësisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale të këtyre zonave.

Aktiviteti i këtyre guroreve përbën rrezik për jetën dhe lëvizjen e banorëve të zonës si edhe të turistëve vendas dhe të huaj që kalojnë pranë këtyre guroreve. Kjo sepse nga monitorimet u nxor në pah se nuk ka asnjë tabelë apo shenjë sinjalizuese si dhe nuk është ndërtuar asnjë masë parandaluese, siç janë muret apo brezat mbrojtës të rrëshqitjes së gurëve dhe masave të tjera inerte.

Faza e dytë konsistoi në realizimin e takimeve me banorë të zonës, e cila siguroi arritjen e dy qëllimeve kryesore. Fillimisht, banorët u informuan në lidhje me gjetjet e analizës juridike dhe analizës mjedisore, si instrument për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe adresimin në rrugë zyrtare të problemit në bashkëpunim me komunitetin. Më pas, u punua për rritjen e kapaciteteve të tyre lidhur me të drejtat ligjore të tyre mbi pasuritë publike, detyrat e pushtetit vendor, detyrimet e subjekteve përfituese ndaj komunitetit dhe mjedisit, me qëllim përmirësimin e qeverisjes lokale.

Figura 21: Takim në Vranisht, Vlorë



Burimi: Shoqata Vizioni i Gjelbër

U zhvilluan takime të hapura në qendrën e fshatit Vranisht me banorë, administratën e bashkisë, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse, përfaqësues të administratës së guroreve. Qëllimi ishte për të arritur një partneritet trepalësh midis pushtetit vendor, biznesit e komunitetit, në adresimin e çështjeve madhore që shqetësojnë komunitetin e zonës, si edhe rëndësinë e rehabilitimit të peizazhit të dëmtuar për shëndetin e ekosistemit dhe zhvillimin e turizmit malor, duke qenë në linjë dhe me prioritetet e pushtetit vendor.

Figura 22: Takim në Vranisht, Vlorë



Burimi: Shoqata Vizioni i Gjelbër

Ky projekt dha një kontribut të veçantë pasi u arrit të kryhej një rehabilitim i pjesshëm i peizazhit natyror të dëmtuar në një nga guroret e synuara. U realizua mbjellja e 460 fidanëve të dafinës, si bimë e njohur e zonës si përpjekje për rivendosjen e ekuilibrave ekologjikë në ekosistemin e dëmtuar dhe nxitjen e subjekteve për rehabilitim të plotë të mjedisit të dëmtuar.

Figura 23: Mbjellje pemë në Vranisht, Vlorë



Burimi: Shoqata Vizioni i Gjelbër

PËRFUNDIME

- Nga vëzhgimi në terren u konstatua se në zonën e Lumit të Vlorës ushtrojnë aktivitetin e tyre për shfrytëzimin e guroveve gjashtë subjekte të cilët kanë mangësi të theksuara në përgatitjen dhe pajisjen e tyre në përputhje me dokumentacionin ligjor që përcakton legjislacioni mjedisor shqiptar. Kjo pasi këto subjekte nuk janë të pajisura më dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Moskryerja e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
 - b. Mungesa e pajisjes me Deklaratën Mjedisore
 - c. Mungesa e pajisjes me Leje Mjedisore dhe Leje Shfrytëzimi të Guroveve.
- Dëmi mjedisor i shkaktuar prej aktivitetit të tyre është i konsiderueshëm në peizazhin natyror të zonës, të sipërfaqes së tokës nën shfrytëzim, i strukturës dhe pjellorisë së tokave përreth tyre për arsye të shkarkimit të lëndëve ndotëse të lëngëta, gurëve dhe materialeve inerte.

- Dëmtim i pyjeve dhe biodiversitetit të zonës, florës dhe faunës së egër të saj për arsye të gërmimeve të karrierës së gurave, hapjes së rrugëve dhe shpërndarjes së masës së dherave, gurëve dhe materialeve inerte në mjedis.
- Dëme në cilësinë e ajrit nga pluhurat që emetohen prej punimeve të guros dhe mjeteve të kompanisë, si edhe atë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për shkak të kryerjes së aktivitetit dhe për mungesë të masave të disiplinimit dhe kullimit të ujërave që parandalojnë erozionin dhe ndotjen.
- Nga vëzhgimi në terren vihet re se nuk janë kryer investime në rehabilitimin mjedisor të zonës si sistemime, mbjellje pemësh, mbushjen dhe sistemimin e gropave të hapura.
- Gjithashtu, është dëmtuar zhvillimi i agro-turizmit, eko-turizmit, turizmit rural dhe atij malor si rezultat i prishjes së peizazhit natyror, pluhurave, zhurmave dhe rreziqeve që ato krijojnë.
- Gjatë takimeve me publikun u konstatua se informimi i publikut dhe bashkëpunimi me komunitetet lokale pothuajse mungon fare. Ky komunitet nuk ka përfituar asnjë investim nga ana e subjekteve përfitues të pasurisë së tyre të përbashkët, aspektin e përmirësimit të infrastrukturës dhe zhvillimit kulturor dhe ekonomik të tyre.
- Në drejtimin juridik bashkia Himarë ka lidhur një kontratë me subjektet në kundërshtim me bazën ligjore dhe jashtë kompetencave të saj dhe sugjerohet që deri në rregullimin e kësaj çështje duhet të pezullohen të gjitha veprimtaritë ekonomike në këtë fushë, pasi po ushtrojnë një aktivitet në kundërshtim me ligjin.
- Bashkia Himarë nuk e ka realizuar monitorimin e mjedisit të subjekteve që ushtrojnë aktivitete minerare në territorin e saj si dhe të zonave përreth, pavarësisht se këto aktivitete ushtrohen jo shumë larg qendrave të banuara.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk realizon monitorim të zonave ku ushtrohet aktiviteti në fushën minerare, por vetëm merr raportime nga subjektet që operojnë në këtë fushë, duke krijuar pengesa në garantimin e mbrojtjes së mjedisit.
- Agjencitë Rajonale të Mjedisit nuk kanë kryer inspektime dhe monitorime në subjektet që ushtrojnë aktivitete në fushën minerare.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk disponon të dhëna për taksat kombëtare që subjektet paguajnë në këtë sektor. Në kuadër të Nismës për Transparencë në industrinë nxjerrëse, këto të dhëna duhet të publikohen në faqen e saj në formën e një broshure.

3.3 KRIJIMI I MODELIT TË STRUKTURAVE TË MIRËMBAJTJES SË VIJËS BREGDETARE DHE BREGLIQENORE SI FUNKSIONE TË BASHKIVE RESPEKTIVE.

Shoqata: "Nisma e luleve"

Bashkia: Sarandë

Në tabanin e detit Jon, dhe më konkretisht në gjirin e Sarandës është nxjerrë në pah një ndotje e madhe e cila vjen e shtohet prej vitit 1991. Edhe pse prej vitit 2019 e deri më sot janë realizuar shumë aktivitete pastrimi vullnetare nga ku janë nxjerrë afërsisht 2,000 goma dhe 40,000 shishe dhe kanoçe, janë identifikuar të ketë dhe mijëra goma dhe plot mbetje të tjera të shpërndara në një gjatësi prej 5 km lineare dhe gjerësi nga bregu deri në 50 metra. Kjo ndotje, që në përditshmëri nuk duket, është me rrezik të madh për faunën dhe florën nënujore, si dhe shëndetin e qytetarëve që pushojnë në Sarandë apo konsumojnë produkte deti nga gjiri i Sarandës. Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e mungesës së strukturave të pastrimit të nëndetit nga ana e bashkisë Sarandë. Bashkia ka sot 60 punonjës pastrim-gjelbërimi në organikën e saj, por asnjë palombar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e detit edhe pse deti është burimi kryesor i të ardhurave të të gjithë rrethit. Zonat më të ndotura janë zonat përpara lokaleve, bareve, restoranteve që ndodhen buzë detit dhe në dukje vihet re se këto subjekte që shfrytëzojnë të mirën publike e dëmtojnë atë, e sidomos për sa i takon zonës nënujore.

Nisma e luleve, në aktivitetet e saj vullnetare në vitin 2018 – 2019 për pastrimin e nëndetit, ka konstatuar se ekziston angazhimi qytetar për sa i takon vullnetarizmit për të marrë pjesë në aktivitetet e pastrimit të realizuara deri më sot. Nga ana tjetër, është ofruar një mbështetje nga bashkia Sarandë duke vendosur në gatishmëri makinën e pastrimit për të transportuar mbetjet në drejtim të landfillit. Aktivitetet e pastrimit kanë ngjallur interes tek mediat lokale dhe kombëtare duke transmetuar këtë problematikë në rang më të gjerë shikueshmërie.

Në këto kushte, projekti synoi të vijonte ndërmarrjen e nismave për të advokuar dhe arritur në marrëveshje me strukturat ligjvënëse për marrjen e masave që mund të ndryshojnë këtë realitet. Aktivitete të tjera priten të zhvillohen në pranverën e vitit 2023.

Më poshtë do të përshkruhen shkurtimisht të gjitha aktivitetet që lidhen me pastrimin e tabanit të detit Jon, përgjatë vitit 2022:

Në maj të 2022, në 3 ishujt në Ksamil, janë nxjerrë nga fundi i detit 60 goma dhe mbetje të tjera plastike duke e çuar numrin total të gomave prej aktivitetit të parë të organizatës, në 1,873 gjithsej.

Figura 24: 3 ishujt në Ksamil



Burimi: Shoqata Nisma e Luleve

Më pas, u vijua me nxjerrjen e gomave në Plazhin e Ri, Sarandë, duke nxjerrë nga fundi i detit 55 goma dhe mbetje të tjera plastike duke e çuar numrin total të gomave prej aktivitetit të parë në 1928. Në tetor, u nxorën 74 goma në Marinë Sarandë duke e çuar numrin total në 2002.

Figura 25: Plazhi i Ri, Sarandë



Burimi: Shoqata Nisma e Luleve

Po këtë muaj u vijua me nxjerrjen e 67 gomave nga Plazhi i Ksamilit. Ky aktivitet u trajtua gjerësisht edhe në mediat televizive, lokale dhe rrjetet sociale.

Ky aksion vijoi në nëntor në plazhin e Pllakave Sarandë, ku janë nxjerrë dhe 48 goma të tjera. Aktiviteti i fundit për nxjerrjen e gomave ishte në dhjetor 2022, ku u nxorën 46 goma të tjera. Në total, numri i gomave, që nga fillimi i aktiviteteve të kësaj organizate, është 2,163.

Figura 26: Plazhi i Pllakave, Sarandë



Burimi: Shoqata Nisma e Luleve

Partneri kryesor i aktiviteteve të zhytjes është *Spiranca Diving Center*, e cila ofron pajisjet e zhytjes dhe ekspertizë për zhytjet prej më shumë se 3 vitesh. Gjithashtu, bashkia Sarandë dha mbështetje në transportin e gomave si dhe mundësi të gjithë grupin e vullnetarëve nga njëri aktivitet në tjetrin, i cili varion midis 20 – 30 persona. E veçanta e këtij aktivitetit është se në këto aktivitete bashkohen dhe vizitorë jo-banues, nga vende të ndryshme të botës.

Projekti zhvilloi dhe aktivitete të tjera informuese dhe ndërgjegjësuese, ku u realizua një takim me bashkinë Sarandë me objektiv krijimin e presionit të nevojshëm qytetar ndaj kësaj bashkie për marrjen e masave sa i takon mbajtjes pastër të detit duke synuar më tej shtrirjen dhe implementimi e këtij modeli në të gjitha bashkitë e vendeve bregdetare dhe bregliqenore.

Figura 27: Takim Bashkia Sarandë

*Burimi: Shoqata Nisma e Luleve*

Në këtë takim, përfaqësuesja e bashkisë prezantoi strukturën që drejton, fokusin e punës dhe proceset që institucioni kryen në kuadër të shërbimeve mjedisore. Ajo theksoi se asnjë nga këto funksione nuk përfshin pastrimin e fundit të detit dhe kjo lidhet edhe me shumë kufizime ligjore në administrimin e detit. Por nga ana tjetër, u nënvizua fakti se falë mbështetjes së agjencive të huaja si GIZ, janë bërë të mundura një sërë ndërhyrjesh për të parandaluar ndotjen e detit me mbetje që krijohen nga konsumi i kryer në tokë dhe nga aktivitetet private që operojnë pranë detit ose nga lundrimet në det.

Këto ndërhyrje konsistojnë në vënien në dispozicion të infrastrukturës për të kryer grumbullimin e veçuar të plastikës, letrës dhe kanoçeve nga bizneset në zonën përgjatë vijës bregdetare dhe më gjerë përmes këtij projekti pilot. Përgjatë shëtitorës janë vendosur disa struktura për grumbullimin e mbetjeve plastike nga qytetarët dhe turistët. Bashkia është përgjegjëse për mbledhjen dhe ndarjen e mbetjeve sipas karakteristikave të riciklueshme dhe për t'i drejtuar më pas në njësitë e menaxhimit të mbetjeve (në kuadër të projektit GIZ). Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me anijet turistike që lundrojnë në brigjet e Sarandës, nëpërmjet të cilave administratorët e anijeve kanë marrë përgjegjësinë për të garantuar që mbetjet e krijuara gjatë kohës që turistët shpenzojnë në udhëtimin e tyre të mos hidhen në det.

Të gjitha këto masa të marra kanë sjellë një ndikim pozitiv në administrimin e mbetjeve që përfundojnë në fund të detit. Megjithatë, bashkia nuk ka kapacitete të mjaftueshme

për menaxhimin e suksesshëm e aq më pak për monitorim të vazhdueshëm të situatës dhe mekanizmave. Sfidë dhe faktor kyç në lidhje me çështjen e ndotjes dhe menaxhimit të mbetjeve është nevoja për ndërgjegjësimin e popullatës. Zgjidhjet afatgjata vijnë vetëm nëse sjellja e qytetarëve ndryshon në raport me mjedisin e përbashkët. Në këtë drejtim, Koordinatori Rajonal i Green-AL theksoi rolin kyç të organizatave të shoqërisë civile të cilat mund të kontribuojnë në këto drejtime, nëse bashkia i konsideron si partnerë në punë.

Figura 28: Roll up statik me mesazhe ndërgjegjësimi për kujdesin ndaj ndotjes detare



Burimi: Shoqata Nisma e Luleve

Përgjatë muajit gusht 2022, u krye një fushatë me mesazhe ndërgjegjësimi për të mbrojtur vijën bregdetare dhe për të minimizuar ndotjen nga fluksi i lartë i turistëve në zonat e

plazheve. Demonstrimi i kryer me anë të *roll-up* statik në mjedise publik me mesazhe ndërgjegjësimi për kujdesin ndaj ndotjes detare u bë i mundur në bashkëpunim me *Spiranca Diving Center*. Kjo e fundit përdori banderolën në varkën me të cilën transporton turistë në thellësi të ujërave për zhytje. Gjithashtu, në bashkëpunim me anijen turistike *Pegasus*, kjo banderolë u përdor përgjatë muajve gusht dhe shtator në zonat ku ato operojnë pasi numri i vizitorëve që vihen në kontakt me këto biznese është i lartë.

Anija viziton plazhe të shumta gjatë gjithë sezonit me mijëra turistë vendas dhe të huaj. U mendua që prezenca e një banderole të fillë do të ndikonte në ndërgjegjësimin e pushuesve për mos të hedhur ndotje në det, por mbledhjen dhe hedhjen e tyre në vende të përcaktuara, të posaçme për mbetjet.

Nga pronarët e anijes raportohet se ka pasur një shkallë të rritur të ndërgjegjësimit dhe në bashkëpunim me bashkinë anijet kanë firmosur kontrata të cilat i detyrojnë ato të sjellin mbetjet e mbledhura në udhëtim në bregun e detit. Gjithashtu, operatorët e pastrimit janë njoftuar dhe udhëzuar për të bërë çdo ditë mbledhjen e tyre në periudhën e kthimit të anijeve në breg.

Gjate muajit nëntor 2022 u realizuan disa takime me studentë të qytetit të Sarandës. Studentët u informuan për situatën e ndotjeve nënujore dhe bregdetare si dhe u nxitën për t'u angazhuar si vullnetarë për këto çështje. Në mbyllje të takimit u shpall konkurs-ideja me tematikë "Ripërdorimi i mbetjeve që nxirren nga fundi i detit, duke krijuar me to vepra artistike, funksionale për qytetin".

Figura 29: Takime me tematikë "Ripërdorimi i mbetjeve që nxirren nga fundi i detit, duke krijuar me to vepra artistike, funksionale për qytetin"





Burimi: Shoqata Nisma e Luleve

Një raport i detajuar mjedisor u hartua lidhur mbi biodiversitetin e habitateve bregdetare, të cilësuar zona të mbrojtura sa më poshtë:

- 1. Zona gjiri i Kakomesë – Kepi i Qefalit**
- 2. Zona Kanali i Çukës – Gjiri i Ksamilit – Ishujt**
- 3. Zona Pagane – Kepi i Stillos – Ishulli i Tongos**

Këto zona rrezikohen nga dëmtimet nga zjarret, erozioni, ndotja e mjedisit, transporti i pakontrolluar detar, zhvillimi pa studime, mungesa e monitorimit, turizmi, aktivitetet e peshkimit dhe akua-kulturës pa studime. Në relacion u vu theks mbi aktivitetet kryesore që kërcënojnë mjedisin në vijën bregdetare, si: trafiku detar dhe ankorimi i anijeve, aktivitetet turistike, menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ujërat e zeza, rreziku nga derdhja e naftës, peshkimi i pakontrolluar, mbledhja e invertebroreve detare (guacka, korale, etj.). Të gjithë këta faktorë ndikojnë në dëmtimin e biodiversitetit ekologjik.

Bazuar në ligjet vendase si dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit detar dhe rajonit bregdetar, synohet parandalimi dhe ndëshkimi për rastet e ndotjeve mjedisore. Nga monitorimet e kryera nga eksperti është vënë re se ndotja e detit është shkaktuar nga mbetjet plastike që vijnë nga lumenjtë, derdhja e ujërave të zeza, rrjedhja e vajrave, inertet nga skafet dhe dyndja e pa kontrolluar e turistëve duke krijuar një gjendje kritike dhe alarmante për mjedisin detar. Nga testimi dhe monitorimi biologjik i ekosistemeve detare, livadheve të Posedonës, bio-indikatorët tregojnë për dëmtime të mëdha të këtyre mjedisve. Sipas këtyre studimeve për mjediset nënujore ku ndalojnë jahtet, anijet, skafet dhe ku zhvillohet aktiviteti i akua-kulturës, ato shfaqin probleme shumë serioze deri në zhdukjen përherë e më tepër të koraleve, livadheve, gjallesave nënujore dhe zëvendësimi i tyre me mbetje.

Në përmbyllje, ajo që evidentohet nga ekspertiza është përgjegjësia e institucioneve të Inspektoratit Mjedor, AKZM (Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura), ADZM (Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura). Sugjerohet që institucionet e bashkive bregdetare dhe bregliqenore të jenë nismëtare në bashkëpunim me AKZM për dhënien e lejeve të hapësirave të plazhit duke pararendosur kushte dhe ndëshkime për ndotjen që shkaktohet nga flukset turistike.

PËRFUNDIME

- Për vitin 2022 janë nxjerrë nga tabani i detit Jon, vetëm në gjirin e Sarandës dhe Ksamilit, 350 goma dhe mbetje të tjera plastike.
- Mbarëvajtja e këtij procesi vazhdon të kryhet nga organizata “Nisma e Luleve”. Institucionet vendore nuk kanë struktura që përgjigjen për pjesën nënujore pasi bashkia e Sarandës e ka përgjegjësinë ligjore deri në vijën e bregut.
- Është ndërgjegjësuar komuniteti lidhur me situatën alarmante dhe pasojat e ndotjes nëpërmjet publikimeve në rrjetet sociale, vendosjes së posterave informues, sesioneve me studentët si dhe nxitja e tyre për t'u përfshirë në aktivitete vullnetare për riciklimin e mbetjeve që gjenden në fund të detit.
- Bashkia e qytetit Sarandë është treguar bashkëpunuese vetëm në rastin e vendosjes në dispozicion të mjeteve transportuese për të larguar gomat dhe mbetjet në drejtim të landfillit por nuk ka ofruar propozime për zgjedhje afatgjata duke shkarkuar përgjegjësinë nga vetja me argumentin se nuk ka legjislacion që i ngarkon organet e saj me detyra për nxjerrjen e papastërtive nga fundi i detit.

3.4 PROJEKTI: NXITJA E NISMAVE LOKALE PËR REDUKTIMIN E MBETJEVE URBANE NË LUMIN E QYTETIT DHE LUMIN E VËRDOVËS

Organizata: New Impact

Bashkia: Pogradec

Ky projekt u shtri në qytetin e Pogradecit i cili gjendet në pjesën lindore të Shqipërisë dhe ofron një mjedis fantastik për turizëm dhe mikpritje. Sezoni i turizmit në këtë qytet është i kërkuar nga turistët në të katërta stinët e vitit por stina më e preferuar mbetet vjeshta. Rrethi i Pogradecit ofron kulinarit tradicionale të zonës, kulturë historike (si varrezat monumentale Ilire të Selcës, Ura e Golikut, Mozaiku i Linit, kalaja e qytetit etj.), monumente kulturore (Guri i Kamjes) dhe muzeu. Në art dhe kulturë rrethi njihet për poetët e shquar Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli dhe shumë autorë të tjerë bashkëkohorë. Liqeni dhe vija bregliqenore e shtrirë që në fshatin Lin deri në Tushemisht (të dyja fshatra turistike, me një peizazh fantastik), e bën një qytet të mrekullueshëm. Kultura dhe mikpritja e qytetarëve, klima e mrekullueshme (me temperatura jo të larta)

bën që vit pas viti të shtohet numri i turistëve të huaj dhe vendas. Mrekulli tjetër është parku i Drilonit që gjendet vetëm 5 km nga Pogradeci.

Aktivitetet kryesore të projektit ishin:

Aktivitet ndërgjegjësimi me nxënësit e gjimnazit "Muharrem Çollaku" ku u bë prezantimi i projektit dhe të rinjtë u ftuan të bëhen pjesë e kësaj nisme shumë të nevojshme. E veçanta e këtij takimi ishte që disa nxënës të cilët jetojnë buzë lumit të qytetit dhanë informacione të vjera për shkaqet e ndotjes, e cila në këtë rast është hedhja e mbeturinave shtëpiake nga një pjesë e banorëve tek lumi i qytetit. Përgjatë lumit, deri në pjesën më të lartë të tij, ndodhen pallate dhe banesa private. Gjithashtu raportohet se, në stinën e verës, ku temperaturat janë më të larta, bëhet shqetësuese edhe aroma e keqe. Pasoja më e rëndë e gjithë këtyre mbetjeve është shkarkimi i tyre në liqen. Sa më shumë të reduktohet sasia e mbetjeve në lumë aq me mirë do të ndikojë edhe në pastërtinë e liqenit, florën, dhe faunën e tij.

Figura 30: Aktivitet ndërgjegjësimi me nxënësit e gjimnazit "Muharrem Çollaku"



Burimi: Shoqata New Impact

Një aktivitet tjetër u organizua në formën e një aksion-veprimi mes vullnetarëve të shoqatës "New Impact" bashkë me nxënësit e gjimnazit "Muharrem Çollaku" dhe gjimnazit "Gjergj Pekmezi" të cilët u mbledhën dhe organizuan pastrimin e lumit nga grykëderdhja deri tek ish-fabrika e qumështit. Gjatë këtij aksioni u mbledhën dhjetëra thasë me plastikë, goma, mbetje urbane dhe barishte, që kishin mbuluar urën tek ish-fabrika e qumështit. Veçojmë se kësaj nisme shumë të domosdoshme, iu bashkuan edhe banorë të zonës dhe kompania REJ sh.p.k për të ndihmuar në aksionin e pastrimit dhe transportimin e mbetjeve të mbledhura.

Lumenjtë sjellin në liqen dhjetëra tonelata me mbetje urbane, kryesisht nga mbetjet që hedhin banorët e fshatrave të Mokrës dhe të banorëve që jetojnë në afërsi të lumit. Mbetjet plastike, përfshirë edhe ato inerte, të hedhura përgjatë lumenjve të qytetit dhe

lumit të Vërdovës përfundojnë në liqenin e Ohrit duke shkaktuar ndotje, që shtrihet disa kilometra përgjatë vijës bregliqenore. Interesante ishte që vetë të rinjtë i bënë thirrje qytetarëve që të mbrojnë lumenjtë dhe të mos i ndotin ato, pasi është përgjegjësia e çdokujt që të mbrojë lumenjtë, mjedisin dhe ujërat.

Figura 31: Pastrimi i lumit të Vërdovës



Burimi: Shoqata New Impact

Organizata "New Impact" zhvilloi edhe sesionin e dytë ndërgjegjësues me të rinjtë e gjimnazit "Muharrem Çollaku". Gjatë gjithë bisedës informuese dhe ndërvepruese me ta, u shkëmbyen ide dhe propozime sado të vogla që sjellin ndryshime domethënëse në përmirësimin e situatës. Nxënësit propozuan disa alternativa se si, të gjithë së bashku, mund t'i mbajmë pastër lumenjtë.

Figura 32: Aktivitet ndërgjegjësimi me nxënësit e gjimnazit "Muharrem Çollaku"



Burimi: Shoqata New Impact

Gjate projektit, u zhvilluan takime me komunitetin e zonës përgjatë lumit të Vërdovës si dhe me disa punonjëse të gjelbërimit që punojnë në atë zonë. Në këto takime komunitare, organizata u njoh me këndvështrimin e banoreve, si dhe morën disa propozime prej tyre për pikat në të cilat mund të vendosen pritrat, si dhe për format e ndërgjegjësimit të popullatës që mund të kenë efekt.

Figura 33: Takime me komunitetin e zonës përgjatë lumit të Vërdovës



Burimi: Shoqata New Impact

U organizua një takim me qytetarë të komunitetit dhe punonjës të mirëmbajtjes/gjelbërimit të bashkisë Pogradec. Ata sugjeruan që të vendosen sanksione dhe gjoba për ata që shkelin ligjin, të vendoset një staf i veçantë i monitorimit, si dhe kamera përgjatë lumenjve.

Takimi përmbyllës u zhvillua në mjediset

e Këshillit Bashkiak për të prezantuar rezultatet e projektit me institucionet e qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të përfshirë në këto procese.

PËRFUNDIME

- Njëpërmjet këtij projekti u ndërgjegjësuam të rinjtë për të ndërmarrë aksione për pastrimin e lumenjve.
- U mundësua komunikimi me banorët që ndodhen përgjatë lumenjve.
- U vendosën prita në lumenj për të parandaluar çdo mbeturinë familjare.

3.5 PROJEKTI: BERATI, QYTET I GJELBËR DHE TË RINJ TË NDËRGJEGJSHËM

Organizata: New Bridges

Bashkia: Berat

Projekti "Berati, qytet i gjelbër dhe të rinj të ndërgjegjshëm" u fokusua në nevojën për të përmirësuar mjedisin natyror në qytetin e Beratit. Edhe pse legjislacioni dhe politika mjedisore kombëtare përcakton masat që duhet të ndërmerren nga pushteti, veprimet e tyre janë të pamjaftueshme për të siguruar një mjedis cilësor për qytetarët beratas. Ekzistojnë politika lokale si Plani i Zhvillimit të Territorit të hartuara në kuadrin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave kombëtare dhe duke ndjekur prioritetet vendore. Megjithatë, zbatimi i tyre është i kufizuar për shkak të burimeve të pamjaftueshme në dispozicion të bashkisë për zgjidhjen e problemeve mjedisore.

Angazhimi i shoqërisë civile në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe angazhimi i tyre në diskutimin e axhendave mjedisore ka qenë i kufizuar për shkak të zhvillimit të ulët të organizatave të shoqërisë civile në Berat. Angazhimi i shoqërisë civile dhe komunitetit për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ka qenë i pamjaftueshëm për shkak të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin të kufizuar. Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe pushtetit vendor ka qenë gjithashtu i kufizuar.

Figura 34: Aktivitet ndërgjegjësimi i qytetarëve



Burimi: Shoqata New Bridges

Shkaqet kryesore të situatës së pakënaqshme të mjedisit në qytetin e Beratit përfshijnë:

- Ndërgjegjësimin e ulët të komunitetit dhe të rinjve.
- Nivelin e ulët të bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe pushtetit vendor.
- Investime të pamjaftueshme për përmirësimin e mjedisit.

Urat e reja fokusohen në malin e Partizanit, i cili shtrihet mbi lagjen “Gorricë” dhe përballë qytetit të Beratit. Mali i Partizanit konsiderohet si mushkëria e qytetit të Beratit. Është një peizazh i bukur për t’u parë dhe qytetarët e Beratit e përdorin për shëtitje dhe rekreacion të përditshëm. Edhe pse në vitet 1970 janë mbjellë pisha, mali është dëmtuar nga zjarret dhe erozioni, duke rrezikuar edhe banorët e lagjes Gorricë.

Projekti synonte të kontribuonte në pyllëzimin e malit të Partizanit nëpërmjet angazhimit të të rinjve dhe bashkëpunimit të tyre me bashkinë dhe komunitetin në tërësi. Ndonëse ndërhyrja është e vogël, për sa i përket parave dhe volumit, vlera reale e saj do të ishte modeli për përmirësimin e mjedisit, i cili mund të kopjohet nga shoqëria civile, komuniteti dhe bashkia. Projekti është në përputhje me Planin e Zhvillimit të Territorit të bashkisë Berat, më konkretisht me objektivin strategjik 2: Ruajtja dhe rigjenerimi i pasurive natyrore dhe kulturore si treguesi kryesor i zhvillimit dhe mirëqenies sociale dhe ekonomike

nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor. Në këtë kuadër, bashkia e Beratit ka plane për pyllëzimin dhe përmirësimin e malit të Partizanit.

Figura 35: Aktivitet ndërgjegjësimi i nxënësve



Burimi: Shoqata New Bridges

Objektivi i projektit ishte "përmirësimi i mjedisit natyror të qytetit të Beratit". Nëpërmjet këtij projekti u synua rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të Beratit për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e habitatit natyror në malin e Partizanit, rritja e bashkëpunimit mes bashkisë Berat dhe shoqërisë civile për adresimin e çështjeve mjedisore.

Përbërësit mbi të cilët u zbatua metodologjia e projektit ishin zhvillimi i kapaciteteve të rinjve për të punuar në çështje mjedisore, rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit, pyllëzimi i malit të Partizanit si dhe bashkëpunimi me bashkinë Berat për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu, angazhimi i grupeve rinore për të bërë presion ndaj pushtetit vendor dhe për të ndërmarrë veprime për përmirësimin e mjedisit ka qenë thelbësor.

Në kuadër të projektit u realizuan: 20 sesione/takime ndërgjegjësuëse me më shumë se 500 nxënës dhe gjimnazistë 9-vjeçarë dhe aktivitete informuese për komunitetin. U pastruan lagjet "Kala", "Mangalem" dhe "Dëshmoret e Kombit" si dhe u krye fushata e pyllëzimit që synon mbjelljen e 1,250 fidanëve pishë në malin e Partizanit. U organizuan tre tryeza të rumbullakëta me pjesëmarrjen e Grupit Rinor *Leader*, shoqërisë civile dhe

bashkisë për të diskutuar hapat e ardhshëm për mbrojtjen e mjedisit. Promovuesit e këtyre aktiviteteve kanë qenë anëtarët e Grupit Rinor *Leader*. Projekti kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit beratas për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e habitatit natyror të malit të Partizanit ku 11 të rinj, anëtarë të Grupit Rinor *Leader* u angazhuan aktivisht për ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit.

Një rezultat i rëndësishëm ishte rritja e bashkëpunimit mes shoqërisë civile, Grupit të Rinjve *Leader* dhe bashkisë Berat për adresimin e çështjeve mjedisore.

Figura 36: Foto nga fushata e pyllëzimit



Burimi: Shoqata *New Bridges*

PËRFUNDIME

- Projekti është zbatuar në bazë të bashkëpunimit me *Leader Youth Group* dhe bashkisë Berat, të cilët morën pjesë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve, duke kontribuar edhe me logjistikën. Ndërhyrja për pyllëzimin e malit të Partizanit është e vogël në vlerë dhe vëllim, por e rëndësishme si një model për përmirësimin e mjedisit që mund të përsëritet nga shoqëria civile dhe pushteti vendor.
- *New Bridges* ka një historik në punën për fuqizimin e të rinjve dhe përmes kësaj nisme, në kuadër të Green-AL, kanë konsoliduar praktikën për fuqizimin e të rinjve në targetimin e çështjeve mjedisore. Grupi kryesor i aktivistëve të rinj do të jetë në fokusin e organizatës edhe përtej projektit, pasi ata do të konsiderohen si aktorë për ndryshim, një aset ku duhet investuar, për të krijuar kushte më solide për një lëvizje mjedisore rinore dhe aksion në Berat. Projekti zhvilloi një praktikë më të mirë të shkëmbimit nga bashkëmoshatarët, në të cilën grupi kryesor i aktivistëve të rinj mjedisorë u angazhua në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve të tjerë përmes sesioneve

edukative të zhvilluara prej tyre në shkolla dhe përmes video-mesazhit si metodë e tregimit.

4. SUGJERIME

Raporti tematik mbi rajonin jugor illustroi nismat dhe aktivitetet e kryera nga organizatat mjedisore gjatë zbatimit të projektit Green-AL, përgjatë dy viteve të para të tij. Aktivitete të shumta informuese dhe ndërgjegjësuese patën si qëllim të përçonin tek grupet e synuara mesazhe të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit, problematika të shumta të lidhura me territorin, si dhe u evidentuan pikat e dobëta të funksionimit të hallkave të ndryshme të ekosistemit institucional dhe lokal të cilat nuk kryejnë siç duhet funksionet për mbrojtjen e mjedisit. Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre si: mbrojtja e ajrit, e ujërave, mbrojtja e tokës dhe e natyrës.

Sugjerimet kryesore që mund të jepen nga ky raport janë:

- Sugjerohet të hartohet një Plan Veprimi dhe Marrëveshje Bashkëpunimi në fushën e mjedisit me të gjithë aktorët duke përfshirë qeverisjen lokale, shoqërinë civile, komunitetin dhe biznesin. Një bashkëpunim i ngushtë mes të gjithë aktorëve të mësipërm është i rëndësishëm për të bërë mbrojtjen e mjedisit sa më funksionale dhe efikase.
- Të propozohet mundësia e ngritjes së një Komiteti Shkencor i përbërë nga vullnetarë që u përkasin shoqatave mjedisore dhe subjekteve të ndryshme kërkimore të cilat të mblidhen së bashku për të vlerësuar nevojat për mbrojtjen e mjedisit, kryerjen e studimeve dhe nxjerrjen e rekomandimeve dhe zgjidhjeve të cilat i paraqiten më pas qeverisjes qendrore apo lokale për përfshirjen e tyre në planet e veprimit për mbrojtjen e ambientit.
- Sfidë kryesore mbetet ndërgjegjësimi dhe motivimi i të rinjve për të marrë pjesë në aksione veprimi për mbrojtjen e mjedisit.
- Informimi i qytetarëve dhe komunitetit si dhe konsultimi publik për çështje që lidhen me mjedisin është kyç në zgjidhjen dhe parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Komuniteti duhet të përfshihet në vendimmarrjen lokale për problematikat mjedisore.
- Të realizohen harta të integruara me gjithë informacionin e nevojshëm turistik, shtigje *hiking*, *mountain bike*, *rafting*, atraksione kulturore dhe natyrore, restorantet, bujtinat, kamping dhe tabela të përgjithshme informative në vendet kryesore turistike të zonës.
- Promovimi i aseteve natyrore dhe elemente të trashëgimisë kulturore për zhvillimin e turizmit .

- Kompanitë e pastrimit në qytet duhet të përmirësojnë cilësinë e punës së tyre dhe të kryejnë pastrimin e zonave, te paktën 2 herë në ditë.
- Në zonat ku kryhet aktiviteti i shfrytëzimit të guroreve, të kryhet një monitorim i rreptë i legjislacionit dhe rregulloreve për zhvillimin e këtij aktiviteti, për të parë efektet në mjedis. Të pezullohet aktiviteti për subjektet që nuk janë në përputhje me ligjin, derisa ato të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar nga legjislacioni shqiptar, siç janë:
 - a. Kryerja e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili jep të dhëna të detajuara lidhur me zonën ku duhet të kryhet ky aktivitet (nëse kemi të bëjmë me zonë të mbrojtur natyrore apo jo), vendin ku vihen mbeturinat dhe rehabilitimin e mjedisit.
 - b. Pajisja me deklaratën mjedisore nga Agjencia e Mjedisit dhe ministria përkatëse.
 - c. Pajisja me leje mjedisore dhe leje shfrytëzimi të guroreve.
- Të kryhet rehabilitimi dhe pastrimi i sipërfaqeve të dëmtuara nga gurët dhe materialet e tjera inerte të depozituara në to, si në terrenin pyjor, edhe në tokat bujqësore.
- Krijimi i zonave të sigurta për shpendët ujorë është parësore. Për shembull mund të ndërtohen ishuj artificialë dhe platforma, për të krijuar zona të favorshme për riprodhim. Gjithashtu, mund të vendosen rrjeta përreth zonave të shpendëve riprodhues, për të zvogëluar hyrjen e grabitqarëve të tyre natyrorë.
- Zbatimi i legjislacionit për ndalimin e gjuetisë, veçanërisht në zonat e mbrojtura, ku gjuetia është e ndaluar. Të rritet kontrollit për kurthet dhe gjuetinë e paligjshme të shpendëve ujorë, e cila është domosdoshmëri për zonën.
- Objektivi kryesor dhe final në zonat buzë detit është nxitja e hartimit të një ligji të posaçëm për pastrimin e shpeshtë të zonave nënujore nga Ministria e Mjedisit.

© COSV, 2023

*Ky material është pronësi intelektuale
e COSV, Coordinamento delle
organizzazioni per il servizio volontario*

